



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

VENDIM

Nr. 21/2019

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 86/2017 “PËR
CAKTIMIN E KRYESIVE TË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME
TË KUVENDIT”**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të neneve 21, pika 1, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në pikën I të vendimit të Kuvendit nr. 86/2017, “Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit”, bëhen këto ndryshime:

I. Deputeti Arben Ahmetaj (PS) caktohet Kryetar në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

II. Deputetja Senida Mesi (PS) caktohet Zëvendëskryetare në Komisionin për Integrimin Europian.

III. Deputeti Niko Peleshi (PS) caktohet Kryetar në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

IV. Deputetja Klodiana Spahiu (PS) caktohet Zëvendëskryetare në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

V. Deputeti Arben Kamami (PS) caktohet sekretar në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 21.1.2019